



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 305 Prot.

Tiranë, më 21.03 2018

VENDIM Nr. 25, datë 21.02.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, datë 21.02.2018, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim të projektit "*Restaurimi i Xhamisë së Plumbit, Shkodër*"- subjekti "Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve, Turqi, pozicionuar brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Shkodrës, paraqitur nga subjekti "Ecolimarlik".

VENDOSI:

1. Të verifikohen nga ASHA të dhënat për veprimtaritë arkeologjike të kryera më parë në këtë zonë, më qëllim kryerjen e sondazheve arkeologjike në pozicionet me intensitet më të lartë arkeologjik, në perimetrin rrethues të pilotave të parashikuar në projekt, për mbrojtjen e "*Xhamisë së Plumbit*", *Shkodër*.
2. Të kryhen nga DRKK Shkodër sondazhet arkeologjike, në perimetrin rrethues të pilotave të parashikuara në projekt, duke u konsultuar më parë me ASHA, e cila do të verifikojë në terren pozicionet e tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al